



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. _____ Prot.

Vlorë më, 09. 03. 2020

VENDIM

Nr. 24, datë 09.03. 2020

**PËR
MIRATIMIN PARAPRAK PËR KRIJIMIN E NJËSISË BAZË TË
HISTORI- GJEOGRAFISË**

Mbështetur në nenin 49, të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në neni 25 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë , si dhe shkresat nr. 122/ 2 datë 21. 01. 2020 të Zv/Rektorit Akademik si dhe shkresës nr. 122/ 1 prot, datë 20. 01. 2020 të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, në mbledhjen e datës 09.03. 2020 Bordi i Administrimit

KONSTATON :

Pranë Bordit të Administrimit është paraqitur për shqyrtin shkresa nr. 122/ 2 prot, datë 21. 01. 2020 e zv/ Rektorit Akademik e cila përcjell kërkesën e Dekanit të Fakultetit të Shkencave Humane për krijimin e njësisë bazë të Histori- Gjeografisë.

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur, Bordi konstaton edhe njëherë një lloj mungese serioziteti në trajtimin e kërkesave të ndryshme nga ana e administratës, e cila ka detyrimin të trajtojë kërkesat konform Vendimit nr. 45 datë 27.09.2019 të BA, duke i shoqëruar me relacionet dhe dokumentacionin përkatës, dhe jo thjesht ti përcjelli për shqyrtim në Bord. Pavarësisht këtij fakti, BA vë re se kjo kërkesë nuk ka efekte financiare shtesë, pasi personeli akademik i cili do të angazhohet pranë njësisë së re, është i organizuar si grup mësimor brenda njësisë baë së Edukimit dhe nuk sjell ndryshim në kategorinë e pagave të personelit akademik. Ky fakt pasqyrohet dhe me shkresën e Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse nr. 122/1 prot, datë 20.01.2020. Një riorganizim në nivel njësie bazë do të sillte një marketim më të mirë, por dhe mundësinë e një pavarësie në vendimarrje me qëllim përthithjen e fondeve nëpërmjet projekteve me financim kombëtar apo të huaj, sidomos atyre ndërkuftare me financim të BE-së.

Në këto kushte Bordi i Administrimit në përputhje dhe me nenin 49, pika 1, gërma dh.
"BA miraton paraprakisht hapjen riorganizimit ose mbylljen e njësisë përbërëse të institucionit të arsimit të lartë" , si dhe nenin 36, pika 6 në të cilin përcaktohet se: "Hapja, riorganizimi ose mbyllja e njësisë bazë të institucioneve të arsimit të lartë bëhen me vendim të Senatit Akademik, në përfundim të vitit akademik, pas miratimit të Bordit të Administrimit".



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

VENDOSI

1. Nisur nga fakti që nuk ka efekte financiare kërkesa e Departamentit t'i përcillet për vendim përfundimtar, Senatit Akademik, si organi më i lartë drejtues akademik.
2. Në mbështetje të shkresës nr. 122/ 1 prot, datë 20. 01. 2020 të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse ky vendim nuk ka efekte financiare.
3. Bashkëlidhur këij vendimi vendoset një kopje e dokumentacionit të ardhur në Bordin e Administrimit për këtë çështje.
4. Një kopje e këtij vendimi i përcillet për dijeni Senatit Akademik dhe Dekanit të Fakultetit të Shkencave Humane.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Dr. ERVIS MOÇKA

